

Die zwei Naturen

Albanische Übersetzung

Guri i ndërtimit Frymor Nr. 69

Dy natyrat

“... Sepse të mirën që dua, nuk e bëj, por të keqen që nuk dua, atë e bëj. Por nëse bëj atë që nuk dua, atëherë nuk e bëj më unë, por mëkati që banon në mua.” (Romakëve 7,14-20).

Vëlla Branham e shpjegoi këtë pjesë të Biblës: Le ta shpreh këtë pak më ndryshe, atë që Pali u tha këtu Romakëve, që ju ta shihni. Ai tha: “Në mua janë dy persona: Njëri dëshiron që unë të bëj atë që është e drejtë, dhe tjetri dëshiron që unë të bëj atë që është e gabuar. Dhe sa herë që filloj të bëj atë që është e drejtë, ajo që është e gabuar më pengon.”

Ti je një njeri i jashtëm, i cili sundohet nga gjashtë shqisat. Krahastij je një njeri i brendshëm, i cili sundohet nga një shqisë, e cila është besimi. Dhe ky besim qëndron në kundërshtim me të gjashtë shqisat, për aq kohë sa ato nuk pajtohen me besimin, sepse ato janë kundër njëra-tjetrës. Tani, për sa kohë që të gjashtë shqisat pajtohen me besimin, kjo është e mrekullueshme; por nëse të gjashtë shqisat nuk pajtohen me besimin, atëherë mos u kushto vëmendje të gjashtë shqisave.

Le të marrim si shembull një premtim që bëri Jezusi. Njeriu i brendshëm thotë se ai është i vërtetë, por njeriu i jashtëm mendon se nuk mund të vlejë për ty. Atëherë mos i kushto vëmendje njeriut të jashtëm, por prano njeriun e brendshëm. Kjo është e njëjta gjë për të cilën flet Pali këtu. Ai ishte shitur nën ligjin e mëkatit mishor, ashtu si secili prej nesh. Prandaj kemi edhe të gjitha këto probleme – të martuar katër ose pesë herë, këtë e atë, dhe të gjitha llojet e mëkatit, shkeljen e kurorës dhe gjithçka tjetër në jetën tonë. Ne jemi mishorë dhe ajo pjesë duhet të vdesë. Por pastaj, brenda, ne jemi një njeri frymor, shpirti në brendësi, dhe ky është besimi në Fjalën e Perëndisë (Marku 11,22). Atëherë, nëpërmjet besimit (Galatasve 2,19-20), ne ia nënshtrojmë trupin tonë të jashtëm Fjalës, duke pranuar atë që Perëndia ka thënë.

Si mund të bëj një kokërr gruri nga një bar i keq? Kjo është e pamundur. E vetmja mënyrë si mund të ndodhë është që në atë bar të keq, nga një grurë i barit të keq, të jetë transferuar një embrion, i quajtur “jeta e grurit”. Pastaj ai grurë i barit të keq varroset; dhe ai do të prodhojë një kokërr gruri, sepse një jetë e grurit është vendosur në barin e keq .

Jeta e barit të keq është hequr, por natyra e barit të keq është ende ngjitesë. Kështu mbetet derisa kjo jetë e re të zhvillohet plotësisht nga toka dhe të rritet përsëri. Kur ajo del, atëherë nuk është më bar i keq, por grurë. Por përderisa një bar i keq është këtu mbi tokë, ai është ende ngjitës. Megjithatë, ai ka natyrën e grurit në brendësinë etij.

Po, për sa kohë që je në këtë jetë, do të jesh ngjitës dhe do të kesh një natyrë mishore që do të të sjellë vështirësi (Galatasve 6,1; Jakobi 3,1-2), për sa kohë që jeton. Por në brendësinë tënde je i rilindur (1.Pjetrit 1,23). Dhe kur të jesh rritur plotësisht, je shëmbëlltyra e Krishtit, dhe i gjithë mëkati është larguar prej teje (Efesianëve 4,15-16; Romakëve 7,21-25). E shihni,këtu qëndron çështja.

A mund ta tregoj këtë ngjarje? Indianët janë njerëz të çuditshëm për ne. Por kur i njeh më mirë, ata janë në rregull. Më kujtohet një në Phoenix, Arizona. Billy zbriti poshtë për të shpërndarë kartat e lutjes. Ai gjithmonë qëndron atje dhe shpërndan kartat e lutjes. Por ndërsa ata që mund të ecnin dhe që në të vërtetë kishin vetëm dhimbje koke, dhimbje dhëmbi ose një gisht të këmbës të lënduar, mund të merrnin një kartë lutjeje, atje rrinin njerëz që po vdisnin nga kanceri ose të gjorë të gjymtuar që nuk mund të hynin në radhën e lutjes. Prandaj i thashë Billy-t që t'i pyeste njerëzit se çfarë u mungon. Dhe nëse nuk kanë kancer ose ndonjë sëmundje tjetër të tmerrshme, atëherë nuk duhet të marrin kartë lutjeje. Vetëm ata duhet të vijnë lart që janë në prag të vdekjes, nëse Zoti nuk i ndihmon. Të tjerët mund të presin dhe ndoshta më pas të hyjnë në një radhë të shpejtë lutjeje.

“Mirë atëherë, do ta bëj.”

Billy zbriti poshtë, dhe aty ishte një indian i moshuar — dhe ata janë vërtet shumë të veçantë — ai nuk donte të ulej në një karrige. I dhanë një karrige, por ai u ul në dyshtin e tendës. Kishte një kapelë në kokë, të cilën nuk donte ta hiqte; prapa ishte ngjitur një pendë — kështu rrinte ulur aty.

Billy shkoi tek ai dhe kaloi pranë tij dhe e pyeti: “A dëshiron një kartë lutjeje?”

“Mmh.”

Billy pyeti: “Çfarë të mundon, kryeplak?”

Ai tha: “Unë sëmurë!”

“Por çfarë të mundon?”

Ai tha: “Unë sëmurë!”

“Por unë do të doja të dija se çfarë të mundon!”

Ai tha: “Unë sëmurë!”

Kjo ishte gjithçka që ai mundi të nxirrte prej tij. Kështu Billy tha: “Mirë, do të kthehem menjëherë” dhe vazhdoi të pyeste njerëzit. Indiani i moshuar vëzhgonte se si kartat e lutjes po bëheshin gjithnjë e më pak. Sa herë që Billy i nxirrte nga xhepi, grumbulli bëhej pak më i vogël. Pas pak kohe, indiani i moshuar u ngrit dhe shkoi pranë, e trokiti Billy-n në shpatull për t’ia kujtuar se edhe ai ishte ende aty. Billy tha: “Kryeplak, çfarë të mundon?”

Ai tha: “Unë sëmure!”

“Pra, kryeplak, duhet të ma thuash. Babai im më tha të mos ua jap këto karta njerëzve që kanë vetëm dhimbje barku ose dhimbje koke, por vetëm atyre që janë vërtetë të sëmure.” Dhe e pyeti: “Sa i sëmure je, kryeplak?”

Ai tha: “Unë sëmure!” Ai u ul përsëri dhe vazhdoi të shikonte kartat. Pak para se ato të mbaronin pothuajse krejt, ai u kthye dhe e trokiti përsëri Billy-n. Billy ia dha kartën në dorë dhe tha: “Kryeplak, shkruaj aty: ‘Unë sëmure.’”

Pastaj ai erdhi në radhën e lutjes, dhe unë u luta për të dhe e pyeta: “A beson, kryeplak?” Ai tha: “Kjo vërtetë.”

Dhe unë thashë: “Tani, a beson se Perëndia do të të shërojë?”

Ai tha: “Kjo vërtetë.”

“A do të jesh edhe një djalë i mirë?”

Ai tha: “Kjo vërtetë.”

Rreth një javë më vonë e takova përsëri dhe e pyeta: “A je mirë, kryeplak?”

Ai tha: “Kjo vërtetë.”

Për ta kuptuar këtë, bisedova me atë misionarin e moshuar, me mustaqe të bardha, atje lart te indianët Apache. Për momentin nuk më kujtohet emri i tij. Ai tha: “Vëlla Branham, kjo është gjithçka që ai mund të thotë. Unë e mësova të thoshte: ‘Unë sëmure.’ Dhe e vetmja gjë që ai mund të thoshte është: ‘Kjo vërtetë.’”

Dikush nga fisi i tij më tregoi për të, se si një herë ishte kthyer në besim dhe kishte marrë Frymën e Shejt. Ai e pyeti: “Si je tani?”

Dhe ai tha: “Shumë mirë dhe shumë keq.”

“Pra, çfarë do të thuash me shumë mirë dhe shumë keq?”

Ai tha: “Epo, që kur kam marrë Frymën e Shejt, janë dy qen brenda meje, dhe njëri prej tyre është qen i zi dhe njëri prej tyre është qen i bardhë. Ata grinden gjatë gjithë kohës. Ata ulërijnë dhe luftojnë kundër njëri-tjetrit. Qeni i bardhë dëshiron që unë të bëj të mirën, dhe qeni i zi dëshiron që unë të bëj të keqen.”

Tjetri tha: “Epo, kryeplak, cili prej tyre e fiton luftën?”

Kryeplaku tha: “Kjo varet nga cili qen ushqehet më shumë nga kryeplaku.” Kështu mendoj se kjo është një përgjigje e mirë këtu. Nga kjo varet rezultati i luftës që është në trupin tënd: Varet nga cilën ushqen, cilën natyrë ushqen; natyrën mishore sipas gjërave të botës apo natyrën frymore sipas gjërave të Perëndisë. Kjo e bën dallimin (2.Pjetrit 1,3-11). [1]

“E falënderoj Perëndinë nëpërmjet Jezus Krishtit, Zotit tonë! Kështu pra, unë vetë me mendjen i shërbej ligjit të Perëndisë, por me mishin ligjit të mëkatit.” (Romakëve 7,25).

Mirë. Kjo është pikërisht ajo që Pali tha shumë herë. Kur dua të bëj të mirën, e keqja është aty (Romakëve 7,21). Pikërisht kështu është edhe me ju. Mendja juaj është zemra juaj (Fjalët e Urta 23,7). Mbani mend, ju nuk mendoni me trurin tuaj dhe nuk shihni me sytë tuaj, por shihni me zemrën tuaj. A e dinit këtë? A e dinit se në zemrën tuaj është edhe një person tjetër, përveç jush vetë? Shkenca e zbuloi këtë rreth katër vjet më parë, e dini. Ata flasin për një dhomëz të vogël në zemër, ku jeton shpirti.

Ishte natyra jote të mos gënjeje. Kjo është arsyeja që ti duhet të jetosh përsëri, sepse je krijuar për të jetuar përgjithmonë, për të jetuar përgjithmonë. Por mëkati hyri dhe solli vdekje për trupin. Kur mëkati hyn dhe sjell vdekje për trupin, atëherë trupi natyrisht duhet të vdesë (Psalmet 51,7). Por në të mund të banojë jeta e përjetshme, nëse kjo frymë në ty përtërihet (Psalmet 51,12) dhe ti ke marrë jetën e përjetshme (Gjoni 5,24-29). Perëndia do ta ringjallë këtë trup në ditën e fundit. Ai e ka thënë këtë.

Ai thotë në një vend tjetër: “Mendoj se kam mendjen e Krishtit.” (1.Korintasve 2,9-16). Tani, në këtë mendje, me mendjen e Krishtit, ti i shërben Perëndisë. Shihni, me pjesën e brendshme i shërben Perëndisë. Në atë nënvetëdiqe qëndron besimi (Romakëve 10,10).

Pali pastaj tha: “Me mendjen time - dhe unë kam mendjen e Krishtit - i shërbej Perëndisë, por me mishin ligjit të mëkatit.” Si ndodh kjo? Sonte mishi im thotë: “Je tepër i lodhur, fyti yt është shumë i ngjirur, sot ke qenë jashtë në erë. Nuk duhet të shkosh sonte në kishë.” Ky është ligji i mishit. Tani, mendja ime, në brendësinë time, Fryma e Shejt foli: “Mbaje premtimin tënd.”

Pali tha: “Mishi im gjithmonë dëshiron t'i dorëzohet kësaj.” Edhe mishi juaj dëshiron ta bëjë këtë. Por ligji i Frymës së Perëndisë në zemër e mposht këtë

Mishin (Galatasve 5,16-18) dhe e bën trupin t'i bindet asaj që zemra thotë të bëhet. Haleluja!

Shikoni, nëse kjo vepron te një mëkatar, atëherë a nuk duhet të funksionojë edhe te sëmundja? Me ligjin e Frymës së Perëndisë në zemër (Romakëve 8,1-11), i cili e di: “Me plagët e Tij ne jemi shëruar” (1.Pjetrit 2,21-25), ata qëndrojnë aty në fuqinë e tyre dhe bëjnë që sëmundja në këtë trup t'u bindet; sepse ai është një djall. Kjo është ajo.

Tani, ligji i mëkatit dhe i vdekjes është duke vepruar në mishin tënd; por ligji i Frymës së jetës është duke vepruar në zemrën tënde.

Pra zemra jote - fryma jote në zemrën tënde - do ta sjellë trupin tënd nën bindjen e saj. Kjo është krejtësisht e saktë. Kështu thotë Pali. Është gjithmonë mishi: “Jam shumë i lodhur, nuk mundem, nuk jam i aftë, nuk mund ta bëj.” [2]

Qeniet engjëjlore bashkohen së bashku. Oh, shpresoj që ta kuptosh këtë. Nëse ke Frymën e Shejt në ty, atëherë je një kandidat për bashkimin me botën e padukshme dhe me të mbinatyreshmen. Nuk është çudi që njerëzit nuk mund t'i besojnë ato gjëra, ata kurrë nuk kanë qenë në kontakt me to. Ata nuk kanë asgjë këtu në zemër që mund të besojë. Por kur Fryma e Shejt hyn në zemër, njeriu menjëherë bëhet një qenie e dyfishtë: njëra nga toka, për të vdekur; dhe njëra në qiell, për të jetuar (Efesianëve 2,4-7). Amen. Në trupin e tij ai është ende i nënshtruar vdekjes, por në shpirtin e tij ai ka kaluar nga vdekja në jetë (Gjoni 5,24). Në trupin e tij ai ka kontaktin e tij tokësor me pesë shqisat e tij; në frymën e tij ai ka një kontakt me Perëndinë përmes Frymës së Shejt. Dhe engjëjt e Perëndisë i vizitojnë ata, flasin me ta, dhe ata janë lajmëtarë të dërguar nga Perëndia, për të zbuluar dhe për të sjellë mesazhe nga Perëndia te individit (Hebrenjve 1,13-14). Ai është atje jashtë për të marrë së pari gjënë e parë. Nuk mund të vendosësh çatinë para se të vendoset themeli. Prandaj duhet ta kemi këtë parasysh: Vendosi gjërat e para në vend të parë! “Por kërkonte së pari Mbretërinë e Perëndisë dhe drejtësinë e Tij, dhe të gjitha këto do t'ju shtohen” (Mateu 6,33). [3]

Ne e dimë se bëjmë gabime, por ti nuk duhet të shikosh te ato. Nuk janë gabimet e tua, sepse ti do t'i kesh gjithmonë ato (Galatasve 6,1). Por, e sheh, çështja është të ndjekësh rregullat e Tij, atë që Ai tha të bëhet. Pengimi dhe rënia nuk kanë fare të bëjnë me këtë. Një shërbëtor me të vërtetë i vërtetë, nëse pengohet, ai do të ngrihet përsëri (Fjalët e Urta 24,16). Nëse lëkundet, Perëndia e tërheq përsëri drejt në rrugë, për sa kohë që ai është në shtegun ...

Detyrë është. Por kur ai largohet nga rruga e detyrës, Perëndia nuk ka më detyrim ndaj tij. Por për sa kohë që ai është në rrugën e detyrës, Perëndia ka detyrim ndaj tij dhe e di se ai është vetëm një burrë ose një grua. Ai ka detyrim ndaj atij personi për sa kohë që ai qëndron në rrugën e detyrës. [4]

Ju më keni dëgjuar të them se dëshmia e Frymës së Shenjtë nuk është të folurit në gjuhë - dhe kështu është - por unë i kam këshilluar këtij personi që t'i kërkojë Perëndisë që ose të flasë në gjuhë ose të profetizojë, sepse kjo është natyra e tij.

Së pari, unë u mora me atë person dhe zbulova vendlindjen e tij dhe nën cilën shenjë kishte lindur, dhe munda të them se si ishte lindja e tij. Ashtu siç është e orientuar qenia e tij natyrore, ai do të drejtohet në një drejtim të caktuar. Kur ata pastaj linden përsëri, atëherë ata kanë brenda një natyrë tjetër (Gjoni 3:3-8). Atëherë në atë natyrë, që është pjesa e brendshme, gjendet një vetëdije e brendshme...

Vetëdija e jashtme të shtyn në një drejtim, kjo është lindja jote natyrore. Pastaj ata mendojnë diçka dhe kjo i vendos në një gjendje të ndarë. Ata nuk dinë çfarë të bëjnë. Ata thonë: “Zoti dëshiron që unë ta bëj këtë.”

Pjesa e brendshme thotë: “Oh, e di se kjo përputhet me Shkrimin.” Dhe atëherë ata fillojnë ta bëjnë, dhe më pas, e dini, Satani në atë anë të jashtme do t'u tregojë atyre çdo lloj gabimi. Dhe atëherë ata thonë: “Ah, unë mendoj se ndoshta jo...” Shihni, ata po e dëgjojnë Satanin. Ju duhet ta merrni atë pjesë të caktuar të brendshme. Ajo që është brenda jush është sipas Shkrimit. Dhe mos i kushtoni vëmendje Satanit! Kjo është detyra e tij, të qëndrojë aty dhe t'ju shqetësojë në atë mënyrë. Por mos e dëgjoni atë!

Dhe ai person që është në ty, që është lindja jote... Ti je Hans Maier, i lindur në një muaj të caktuar, i lindur nën një yll të caktuar, i lindur nën një gjë të caktuar, dhe kjo ka të bëjë me ty. Sigurisht.

Tani, kjo është mënyra jote e lindjes; kjo është ajo që je ti, një burrë natyror ose një grua natyrore. Por kur u rilinde, nuk është vetëdija e jashtme. E jashtmeja është ajo që sheh, shijon, ndien, nuhat dhe dëgjon, por ajo e brendshme është ajo që je me të vërtetë. Tani, me këtë pjesë të jashtme Satani përpiqet të të tundojë dhe të të godasë sa andej-kënde me çdo mjet. Por thellë këtu brenda ai nuk mundet, përveç nëse ti e lejon. Sepse këtu brenda ke besim (2 Korintasve 4:13-15), dhe besimi nuk vjen nga vetëdija e jashtme, e cila mendon. Sepse në besim nuk ka të menduar. Ti e ke marrë atë nga Perëndia dhe e di se ai është aty. Nuk ka rëndësi,

sado e gabuar të duket, ti megjithatë e di se është e drejtë, është KËSHTU THOTË ZOTI. Dhe asgjë nuk do ta pengojë atë. Asgjë nuk mund ta pengojë; ai vazhdon drejt përpara. Problemet ose vështirësitë nuk do të thonë asgjë për të; ti thjesht lufton përmes tyre, sepse është Fjala. Dhe Fjala është shpata, dhe Fjala pret (Hebrenjve 4:12-13). Shpata e çliron veten duke prerë larg nga çdo gjë tjetër. Shihni, nevojitet dora e besimit për ta mbajtur këtë Fjalë. Ky besim duhet të jetë ai... [5]

Kjo është një frymë që po vdes në një trup që po vdes. Por ti nuk mund të jesh në të njëjtën kohë në dy trupa, megjithatë në të njëjtën kohë mund të jenë dy natyra në ty. Sepse kur je rilindur, nuk je lindur fizikisht si foshnja; por ajo që ka ndodhur është se lindja frymërore ka ardhur tek ti (Titit 3:4-7). Ndërsa kjo lindje frymërore rritet në zemrën tënde nga Perëndia, aty është një trup fizik ose një trup qiellor që po rritet për ta pranuar atë frymë. Dhe kur jeta e lë këtë trup, ajo shkon në atë trup. Pikërisht kur trupi i dorëzohet tokës, fryma hyn në të; dhe kur fryma del nga trupi, aty pret një trup. “Sepse ne e dimë se, nëse kjo banesë tokësore prishet, ne tashmë kemi një tjetër që pret.” (2 Korintasve 5:1-3). Ky është ai, trupi frymëror i njeriut. [1]

Ashtu si në librin këtu dhe në pjesën për të cilën kemi folur, se dy librat janë një - Libri i Jetës. Libri i parë i Jetës erdhi kur ti linde. Kjo ishte lindja jote natyrore. Por pastaj një herë, thellë aty brenda, ishte një farë e vogël jete. Shihni, një farë e vogël jete qëndron aty brenda, për të cilën pyet veten: “Nga erdhi ajo? Çfarë janë këto gjëra të çuditshme?”

Po e them këtë duke e marrë veten si shembull. Ashtu siç mund të kishe thënë: “William Branham para dyzet vjetësh dhe William Branham sot janë i njëjti.” Dhe dikush tjetër do të thoshte: “Oh, ai ishte një mashtrues i keq.” Shihni, sepse unë linda nga Charles dhe Ella Branham; në natyrën e tyre unë isha një mëkatar. Erdha në botë si gënjeshtar dhe të gjitha zakonet e botës ishin plotësisht në mua. Por aty brenda ishte gjithashtu e pranishme një natyrë tjetër, e paracaktuar, e vendosur aty nga Perëndia. Në këtë trup të njëjtë janë dy natyra.

Tani, unë isha i përqendruar vetëm tek njëra. Ndërsa ajo rritej, belbëzoja si foshnjë: “Da-da.” Gjëja e parë, u bëra gënjeshtar dhe gjithçka tjetër që e bën një mëkatar, sepse u rrita në atë mënyrë. Por aty brenda ishte gjatë gjithë kohës një shkëndijë e vogël jete.

Me kujtohet, se kur isha djalë i vogël, shpesh ulesha natën jashtë pranë bregut të përroit dhe shikoja përreth. Babai dhe nëna kishin shkuar tashmë për të pushuar. Në ato ditë ata ishin mëkatarë, nuk kishte aspak asgjë të krishterë në shtëpitë tona. Dhe, oh, pirja dhe festat e natës e përsëri - kjo më sëmurte. Merrja fenerin tim dhe qenin tim dhe shkoja në pyll. Atje qëndroja tërë natën. Në kohën e dimrit gjuaja derisa festa të mbaronte, ndoshta deri në agim. Kur kthehesha në shtëpi dhe ajo ende nuk kishte mbaruar, atëherë shtrihesha sipër një stalle dhe flija duke pritur zbardhjen e ditës.

Pastaj mendoja për ato kohë kur isha jashtë gjatë verës. Mblidhja degët e mia dhe i vendosja si një strehë të vogël kundër erës, në rast se binte shi. Atje shtrihesha dhe mbaja shkopinj të ujë për të peshkuar; qeni im i vjetër leshatak rrinte aty pranë. Thashë: “Shiko këtu. A e di, dimrin e kaluar kam fjetur një natë pikërisht këtu. Kam bërë një zjarr pikërisht këtu, ndërsa prisja qenin tim të vjetër të vinte te pema ku kisha ndezur zjarrin. Toka ishte e ngrirë pesë inç thellë. Por lule e vogël, nga ke ardhur? Dhe tani nga dole këtu? Kush erdhi këtu dhe të mbolli? Dhe nga cila serë të sollën? Apo si ndodhi kjo, nga ke ardhur?”

Shihni, atë lule të vogël, i thashë: “Po, por gjithçka ishte e ngrirë, dhe unë pikërisht këtu kam ndezur një zjarr. Përveç elementit të ngricës, aty ishte edhe një element nxehtësie, që ishte në atë trung të madh të vjetër druri kur e dogja. E megjithatë ti je këtu, je gjallë. Nga ke ardhur?”

Çfarë ishte ajo? Aty ishte një William Branham tjetër. Shihni, një shkëndijë e vogël e jetës së përjetshme aty brenda, nga trashëgimia e Perëndisë; Fjala e Perëndisë ishte vendosur aty brenda. Secili prej jush mund të kujtojë përvoja të ngjashme. Shihni, ajo po vepronte.

Pastaj shikova lart drejt pemëve dhe mendova: “Gjethe, të pashë vitin e kaluar të biesh, dhe si është e mundur që tani je përsëri këtu? Nga ke ardhur? Çfarë të solli këtu?” Shihni, ishte ajo jetë e përjetshme që vepronte në atë trup.

Dhe pastaj një ditë, ndërsa vazhdoja të ecja, ai Zë foli: “Mos pi kurrë duhan dhe mos pi kurrë alkool!” Dhe djemtë e rinj dhe të gjithë të tjerët po rriteshin. Shihni, diçka po lëvizte!

Por papritur ngrita sytë dhe thashë: “Unë nuk jam biri i Charles dhe Ella Branham. Ka diçka që thërret.” Ashtu si shqiponja ime e vogël: “Unë nuk jam pulë. Ka diçka atje përtej, diku. O Jehova i madh, kushdo që je Ti, hapu! Unë dua të kthehem në shtëpi. Ka diçka brenda meje që thërret.”

Pastaj u rilinda. Ajo jetë e vogël ishte aty, mbi të u derdh uji i Jetës dhe atëherë ajo filloi të rritej. Ajo jetë e vjetër u fal, u fundos në detin e harresës tek Perëndia dhe nuk do të sillet më kurrë kundër meje. Tani qëndrojmë të shfajësuar në praninë e Perëndisë (Romakëve 5:1-2), sikur të mos kishim mëkatuar kurrë! (Mikea 7:19). [1]

